



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E KULTURËS

RAPORT MONITORIMI  
ZBATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT TË  
MINISTRISË SË KULTURËS  
2022

[www.kultura.gov.al](http://www.kultura.gov.al)

**RAPORT MONITORIMI ZBATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT TË MINISTRISË  
SË KULTURËS**

2022

**Përmbledhje ekzekutive**

**Objektivi 1: Procese dhe rregulla të qarta mbi aspekte të integritetit në MK - në mënyrë që të minimizohet cënimi i tyre nga risqet e integritetit**

**Objektivi 2: Burime njerëzore adekuate, të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnime të përshtatshme për ti rezistuar shkeljeve të integritetit**

**Objektivi 3: Transparenca më e lartë e punës dhe e veprimtarisë së MK brenda institucionit, me aktorë të jashtëm të interesuar për publikun**

**Konkluzione dhe rekomandime**

### **Lista e shkurtesave**

MK – Ministria e Kulturës

AB – Auditi Brendshëm

DMBNJASH – Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve

DPSZHK – Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Kulturor

DZHPK – Drejtoria e Zhvillimit të Programeve të Kulturës

DKFP – Drejtoria e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve

DPSHKRR – Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator

DDA – Drejtoria e të Drejtës së Autorit

DIKMA – Drejtoria e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjes dhe Asistencës

DPKPPP – Drejtoria e Prokurimeve, Koncesioneve dhe PPP-ve

DBMF – Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit të Financës



## **Përmbledhje ekzekutive**

Lufta kundër korrupsionit është prioritet i qeverisë shqiptare. Angazhimi në forcimin e kuadrit institucional, strategjik, ligjor dhe operacional në fushën antikorrupsion ka çuar drejt hartimit, miratimit dhe aplikimit të instrumenteve konkrete kundër korrupsionit me qasje parandaluese dhe ndëshkuese.

Në kontekstin e sektorit publik, integriteti konsiston në përmbushjen e detyrimeve të: transparencës, llogaridhënies, etikës, ndershmërisë, efektivitetit dhe efikasitetit në përmbushjen e detyrave dhe të ushtrimit të funksioneve rregullatore dhe administrative. Vendosija e planit të integritetit dhe sigurimi i zbatimit të tij garanton masat antikorrupsion dhe një mundësi të shtuar të suksesit të zbatimit të tyre.

Raporti i monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Ministrisë së Kulturës, përmban një analizë të përgjithshme të performancës institucionale për ti rezistuar shkeljeve të integritetit si dhe çështje të transparencës institucionale në luftën kundër korrupsionit.

## **Metodologjia e vlerësimit**

Ky raport është hartuar në bazë të kontributit të 8 drejtorive në Ministrinë e Kulturës, Raporti përmban një analizë sintezë të kontributit të tyre.

## **Mbledhja dhe analiza e të dhënave**

Të dhënat e këtij raporti janë grumbulluar nga Koordinatori i Integritetit të Ministrisë së Kulturës, në përmbushje të rolit të tij, si struktura e posaçme përgjegjëse për mbledhjen, analizën e informacionit, si edhe për hartimin e raportit të monitorimit. Koordinatori i Integritetit i raporton titullarit të institucionit mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Integritetit. Titullari i institucionit merr masa për garantimin e zbatimit të Planit të Integritetit dhe adresimin e problematikave të mundshme. Këto të dhëna janë raportuar nga përfaqësuesit e njësive kontribuuese në këtë raport, të cilat janë: - Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës; - Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse; - Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Kulturën; - Sektori i Auditit në Ministrinë e Kulturës. Mbledhja e informacionit nga këto njësi është kryer nëpërmjet plotësimit të aneksit të këtij raporti. Secila njësi ka raportuar mbi: hapat e ndërmarrë dhe statusin e realizimit të tyre për çdo masë të parashikuar për zbatim për periudhën. Draft-raporti i hartuar është konsultuar me njësitë përgjegjëse për zbatim dhe raportim. Përpara publikimit, draft-raporti është miratuar nga Ministri Kulturës.

## Gjetjet e raportit

### **Objektivi 1: Procese dhe rregulla të qarta mbi aspekte të integritetit në MK – në mënyrë që të minimizohet çënimi i tyre nga risqet e integritetit**

Përmes këtij objektivi synohet përmirësimi dhe forcimi i integritetit të institucionit të Ministrisë së Kulturës nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të kuadrit të nevojshëm rregullator Ky objektivi përmban një numër specifikë të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira, të cilat i referohen kuadrit rregullator të brendshëm të integritetit.

Kodi i Etikës së Ministrisë së Kulturës, ka hyrë në fuqi në datë 19.2.2020 në të cilin janë reflektuar dispozitat mbi veprimtarinë e jashtme dhe dhuratat, si dhe sjelljen e punonjësve në raport me to. Dokumentet kryesore të MK-se që lidhen me detyrat dhe sjelljen etike si Rregullorja e Brendshme, Kodi i Etikës, Rregullorja për mbrojtjen e sinjalizuesit, Rregullorja për parandalimin e Konfliktit të Interesave, janë vënë në dispozicion punonjësve ekzistues dhe punonjësve të emëruar rishtazi, në momentin e fillimit të detyrës pranë institucionit.

Në Rregulloren e Brendshme të Ministrisë së Kulturës, janë parashikuar misioni dhe qëllimi i drejtorisë/vektorit përkatës. Detyrat specifike për çdo nëpunës/punonjës të aparatit janë të reflektuara në përshkrimin e pozicionit të punës. Përshkrimet e punës i vihen në dispozicion të gjithë punonjësve të rinj në momentin e nisjes së punës pranë institucionit.

Njësitë raportuese për këtë objektivi janë strukturat e drejtorisë së burimeve njerëzore dhe të drejtorisë së hartimit dhe harmonizimit të kuadrit rregullator. Është kryer plotësisht vetëdeklarimi i punonjësve/stafit të MK për angazhimin në veprimtari të jashtme sipas parashikimeve të ligjit 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

Njësia e burimeve njerëzore është në proces të hartimit të një plani trajnimi të brendshëm mbi procedurat dhe rregullat e parandalimit të konfliktit të interesit, si dhe hartimin e një materiali informues mbi parandalimin e konfliktit të interesit. Do të vijohet me trajnimin e stafit për ndërgjegjësimin mbi rregullat e trajtimit të dhuratave.

### **Objektivi 2: Burime njerëzore adekuate, të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnime të përshtatshme për të rezistuar shkeljeve të integritetit**

Përmes këtij objektivi synohet mirëfunksionimi i administratës të institucionit të Ministrisë së Kulturës nëpërmjet vendosjes së linjave të qarta hierarkike, sanksionimit të një procedure të qartë të të gjitha proceseve të punës në njësitë e ministrisë, forcimit të kapaciteteve njerëzore e profesionale të fushës por edhe rekrutimin e stafit në mungesë në përputhje me strukturën dhe organikën në fuqi të ministrisë. Në fund të çdo viti kalendarik, njësia e burimeve njerëzore harton planin e nevojave për rekrutimin për vitin pasardhës. Në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, ndjek përgjatë vitit procesin e rekrutimit të vendeve vakante. Gjithashtu, njësia e burimeve njerëzore, ndjek dhe monitoron kryerjen e trajnimit të detyrueshëm pranë ASPA, për nëpunësit civil në periudhë prove.

Ministria e Kulturës, aktualisht është në proces të rishikimit të strukturës organizative.

Njësia e burimeve njerëzore, është në proces të hartimit të një plani për trajnimin e sekretarive teknike të organeve kolegjiale të ngritura pranë Ministrisë së Kulturës.

Njësia e burimeve njerëzore, ka parashikuar dhe do të jetë pjesë e ristrukturimit të aparatit, për shtimin e kapaciteteve në sektorin e auditimit të brendshëm.



Trajnimet që lidhen me menaxhimin e programeve buxhetore ndiqen në mënyrë të vazhdueshme nga punonjësit Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar ne Ministrinë e Kulturës

Pranë Ministrisë se Kulturës është ngritur grupi i punës për vlerësimin dhe analizën funksionale të strukturës aktuale dhe propozimin e projekt-strukturës së re, mbështetur edhe në rekomandimet e KLSH, drejtorive të përmbajtjes etj.

Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 26.2.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civile”, njësia e burimeve njerëzore koordinon procesin e vlerësimit periodik 6-mujor, për nëpunësit civil të aparatit.

Në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, hartohet plani vjetor i trajnimeve për të gjithë nëpunësit sipas fushës së tyre të përgjegjësisë.

Përgjatë vitit 2022 Ministria e Kulturës ka plotësuar pozicionet vakante referuar tabelës bashkëlidhur:

1	Drejtor i Përgjithshëm	Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështëse	26.10.2022
2	Drejtor i Përgjithshëm	Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Kultures	10.10.2022
3	Drejtor	Drejtoria e Koncesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve	18.2.2022
4	Përgjegjës Sektori	Sektori i Buxhetit	22.2.2022
5	Specialist	Sektori i Programimit, Hartimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore	19.12.2022
6	Specialist	Sektori i Regjistrimit	14.11.2022
7	Specialist	Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave	3.10.2022
8	Specialist	Sektori i Auditit të Brendshëm	26.6.2022
9	Specialist	Sektori i Programeve të Zhvillimit të Krijimtarisë Artistike dhe Leximit	2.6.2022
10	Specialist	Sektori i Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve për Kulturën	29.4.2022
11	Specialist	Sektori i Bashkëpunimit Marreveshjeve dhe Kontratave	24.3.2022
12	Specialist	Sektori i Monitorimit	24.3.2022
13	Specialist	Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave	9.3.2022
14	Specialist	Sektori i Këshillimit Ligjor dhe Monitorimit të Impaktit të Akteve Rregullatore	3.2.2022

### **Objektivi 3: Transparenca më e lartë e punës dhe e veprimtarisë së MK brenda institucionit, me aktorë të jashtëm të interesuar për publikun**

Përmes këtij objektivi synohet rritja dhe përmirësimi i transparencës dhe veprimtarisë së institucionit të Ministrisë së Kulturës, kundrejt grupeve të interesit dhe publikut nëpërmjet zbatimit dhe përdorimit të instrumenteve të të drejtës së informimit, konsultimit publik, të tjera forma të bashkëveprimit aktiv institucion-të interesuar.

Për këtë periudhë monitorimi, janar-dhjetor 2022, janë shënuar arritje shumë të mira në funksion të rritjes së transparencës dhe konsultimit publik.

Gjitashtu Kodi i Etikës së institucionit është i publikuar në linkun: <https://kultura.gov.al/?s=kodi+etikes>

Programi i Transparencës është riformatuar dhe publik dhe funksional në ofrimin e informacioneve, në linkun: <https://kultura.gov.al/programi-transparences/>

### **Konkluzione dhe Rekomandime**

Ky raport monitorimi është kryer në përputhje me metodologjinë e monitorimit të instrumentit plan integriteti. Viti 2022, ishte viti i parë i zbatimit të këtij plani integriteti në Ministrinë e Kulturës, vit gjatë të cilit u hasën edhe disa vështirësi që patën ndikimin e tyre mbi ecurinë e zbatimit të tij, sipas parashikimeve të bëra dhe afateve konkrete. Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën janar-dhjetor 2022, të gjetjeve që ky dokument na ofron, të të dhënave që drejtoritë kanë raportuar dhe të analizës së kryer, rezultojnë se: - Ministria e Kulturës ka vijuar me zbatimin e planit të integritetit. - Njësitë (drejtoritë) teknike të ministrisë kanë shënuar përparime kryesisht në forcimin e kapaciteteve të stafit, të stafit të ri të rekrutuar, në rishikimin e strukturës dhe në fillimin nga hartimi të paketës së plotë të kuadrit të etikës, integritetit dhe të instrumenteve e mekanizmave rregullatore antikorrupsion. Miratimi i një strukture dhe organike të re të Ministrisë së Kulturës, i cili është ende në proces. Është garantuar transparencë e plotë dhe ofrim i informacioneve mbi aktivitetin e ministrisë për publikun e gjerë nëpërmjet faqes së internetit [www.kultura.gov.al](http://www.kultura.gov.al). Të bëhet informimi/kryerja e trajnimeve të brendshme të stafit të MK-së për rregullat e integritetit (Kod Etike dhe rregullat e tij); - Të plotësohen vakancat në ministri në të gjithë strukturat ku rezultojnë; - Të vijohet me hartimin e hartës së proceseve të punës.